

KUSHTET E BIZNESIT

I. KUSHTE TE PERGJITHSHME

1. Qellimi i aplikimit

Kushtet e pergjithshme te biznesit rregullojne te gjitha marredheniet e biznesit mes klientit dhe zyrave te Bankes se Bashkuar te Shqiperise (ketej e tutje referuar si "Banka"). Pervec kesaj, marredheniet e vecanta te biznesit drejtohen nga Kushtet te Vecanta, te cilat permbajne devijime ose plotesime te Kushteve te Pergjithshme te Biznesit; me keto kushte bihet dakort me klientin kur hapet nje llogari apo jepet nje urdher.

2. Ndryshimet

BBSH do të njoftojë Klientin per ndryshimet ne Kushtet e Punes dhe Buletin e Normave te Fitimit (nese ka ndryshime) 15 ditë para se ndryshimet të hyjnë në fuqi, duke përdorur mjete te qendrushme komunikimi (e-mail, etj.) ose mesazhe telefonike, si dhe duke i publikuar ndryshimet në ambjentet e degeve te BBSH dhe në faqen zyrtare te BBSH: www.uba.com.al. Nëse Klienti nuk paraqitet ne banke brenda ketij afati, atehere do te konsiderohet se ai deshiron ta vazhdoje kontraten me banken dhe ka pranuar ndryshimet e njoftuara. Perndryshe, Klienti eshte i lire ta perfundoje marredhenien me banken kundrejt nje njoftimi paraprak 5-ditor.

3. Sekreti Bankar dhe dhenia e sekretit bankar

a) Ruajtja e informacionit:

Banka ka per detyre te ruaje sekretin per cdo fakt dhe vleresim lidhur me klientin per te cilat ka djeni (sekreti Bankar). Banka mund te jap informacione qe lidhen me klientin vetem ne qofte se kjo kerkohej nga ligji, ose ne qofte se Banka eshte e autorizuar te jape informacion.

b) Dhenia e informacionit:

Banka mund t'i jape nje pale te trete informacionin bankar te kerkuar lidhur me Klientin vetem nese eshte autorizuar me shkrim nga Klienti dhe ne masen e autorizuar prej tij. Banka mund ta beje te njohur informacionin lidhur me Klientin kur Banka eshte e detyruar sipas ligjeve dhe rregullave ne fuqi. Ne kete rast kur konfidencialiteti kufizohet apo perjashtohet me ligj Banka nuk do te jete pergjegjese per pasojat.

Klienti mban pergjegjese per te ruajtur konfidencialitetin ne marredheniet e tij me Banken, per cdo marreveshje me shkrim apo me goje lidhur me te.

4. Detyrimet e Bankes; Neglizhenca kontribuese e klientit

a) Parimet e detyrimit

Ne permbushje te detyrimeve te saj Banka do te jete pergjegjese vetem per pakujdesi te renda nga ana e stafit te saj. Keto rregulla jane te vlefshme pervec rasti kur Kushtet e Vecanta per marredhenie te vecanta biznesi ose marreveshje te tjera permbajne rregulla te ndryshme. Ne rast se klienti ka kontribuar ne realizimin e humbjes per faj te tij (p.sh. duke shkelur detyrimin per te bashkepunuar sic eshte permendur ne Nr.11 te ketyre Kushteve te Biznesit), parimet e neglizhences kontribuese do te percaktojne shkallen ne te cilen Banka dhe klienti do te mbartin humbjen.

b) Urdherat e kaluar paleve te trete

Ne qofte se permbajtja e nje urdhri eshte e tille qe Banka ja beson ekzekutimin e metejshej me te tij nje pale te trete, atehere Banka kryen urdhrin duke e kaluar ate tek pala e trete ne emrin e vet (urdhri kalon tek pala e trete). Ne raste te tilla, detyrimi i Bankes do te jete i kufizuar nga zgjedhja dhe udhezimi i kujdesshem i pales se trete.

Banka do te vendose sekuestro mbi llogarite e klientit kur kjo urdherohet nga organet kompetente shteterore e permbaruesit gjyqesore, pa autorizim nga klienti.

c) Shqetesimet e biznesit

Banka nuk ka detyrime per humbjet e shkaktuara nga forcat madhore, trazirat, lufterat apo fenomenet natyrore, apo per ngjarje te tjera per te cilat ajo nuk mban pergjegjese (p.sh. greva, vonesa nga trafiku, akte administrative te autoriteteve te larta te brendshme apo te huaja).

d) Kufizimet e pretendimeve te klientit

Klienti mund te kete pretendime kundrejt Bankes vetem ne qofte se pretendimet e tij bazohen ne prova shkresore ose nese jane konfirmuar nga nje vendim perfundimtar gjyqesor.

5. E drejta per disponim ne rast vdekjeje te klientit

Ne rast vdekjeje te klientit, nje menyre qe te qartesoje te drejten e disponimit, Banka mund te kerkoje paraqitjen e nje certifikate trashemie, nje certifikate per te drejten e ekzekutimit ose dokumente te tjere te kerkuar per qellime te tilla. Nese Banka e kerkon, cdo dokument ne gjuhe te huaj duhet te dorezohet e perkthyer ne shqip. Si

person te autorizuar, Banka mund te konsideroje cdo person te pershkruar aty si trashëgimtar apo ekzekutor, te lejoje kete person te disponoje pasurine, dhe ne vecanti, t'i beje pagesa apo dorezime ketij personi, pra te shlyeje detyrimet ndaj tij.

6. Ligji i aplikueshem

Ligji Shqiptar eshte ai qe aplikohet ne marredheniet e biznesit mes klientit dhe Bankes, pavaresisht shtetesise se klientit.

7. Pasqyrat periodike te gjendjes se llogarive

a) Nxjerrja e pasqyrave periodike

Me perjashtim te rastit kur bihet dakord ndryshe, Banka nxjerr nje pasqyre periodike per llogarite rrjedhese ne fund te cdo viti kalendarik, me kerkese te klientit, duke qartësuar keshtu pretendimet e mbledhura nga te dyja palet gjate kesaj periudhe (perfshire kushtet dhe komisionet e aplikuar nga Banka). Banka mund te aplikojë norme fitimi mbi tepricen qe lind ne perputhje me nr.12 te ketyre Kushteve apo cdo marreveshje tjetër me klientin.

b) Afati i paraqitjes se verejtjeve; aprovimi ne heshtje.

Cdo verejtje qe mund te kete nje klient ne lidhje me pasaktesine ose paplotesine e nje pasqyre te llogarise duhet te paraqitet me shkrim prane sherbimit me klientin brenda 30 diteve nga marrja e kesaj pasqyre. Mosparaqitja e verejtjeve brenda kesaj kohe do te konsiderohet si aprovim.

8. Stornimet e bera nga Banka

Regjistrimet e pasakta ne llogari (p.sh per shkak te numrit te gabuar te llogarise) mund te korrigjohen nga Banka nepermjet nje regjistrimi ne debi deri ne masen ku Banka ka nje pretendim ripagimi. Ne kete rast, klienti nuk mund te kundërshtojë kete debitim duke pretenduar mosrevokimin e regjistrimit ne kredi.

9. Urdherat per arketim

Nese Banka, ne raste te vecanta, krediton kundervleren e ceqeve perpara pageses se tyre, kjo behet me kusht pagese, edhe nese keto artikuj jane te pagueshem ndaj vete Bankes. Nese ceqet nuk paguhen, Banka do te anulloje kreditimin me kusht, pavaresisht nga fakti nese ka leshuar apo jo nderkohe nje pasqyre.

10. Rreziku i Transaksioneve dhe llogarive ne valute te huaj

a) Regjistrimet ne kredi per transaksionet ne valute te huaj me klientin

Nese Banka perfundon nje transaksion me klientin ne te cilin ajo detyrohet te jape nje shume ne valute te huaj, Banka do te shlyeje detyrimin duke kredituar llogarine e Klientit ne valuten perkatese.

b) Rreziku i kursit te kembimit

Nepermjet ketyre kushteve te biznesit, BBSH i ben te njohura Klientit te gjitha rreziqet qe mund t'i sjelle aktivitetit dhe qarkullimit te tij te parase kreditimi ne nje monedhe te ndryshme nga ajo e arketimeve te tij. Luhajtet e kursit te kembimit midis monedhave, mund t'i shkaktojne Klientit dem financiar. BBSH nuk do te jete pergjegjese per keto deme. Klienti e autorizon BBSH te debitoje llogarite e tij ne te gjitha monedhat per te shlyer detyrimet e tij kundrejt BBSH.

11. Detyrimet e Klientit per te bashkepunuar

a) Ndryshimi i emrit te klientit, adreses dhe perfaqesimit ndaj Bankes.

Nje marreveshje e rregullt biznesi kerkon qe klienti te njoftoje pa vonesa Banken per cdo ndryshim te emrit dhe adreses, sikurse edhe te mbarimit apo shtimit te ndonje tagri perfaqesimi ndaj Bankes te dhena nje personi (ne vecanti prokura). Kjo detyre njoftimi gjithashtu ekziston kur tagrat e perfaqesimit regjistrohen ne nje regjister publik dhe cdo mbarim apo ndryshim i tyre regjistrohet ne ate regjister.

b) Qartesia e Urdhrave

Urdherat e cdo lloji duhet te kene permbajtje te qarte. Urdherat qe nuk jane shprehur qarte cojne ne pyetje, qe mund te rezultojne ne vonesa. Ne menyre te vecante kur jepen urdhera per debitimin e nje llogarie (p.sh urdher-transferte), klienti duhet te siguroje korrektesine dhe plotesine e emrit te perfituesit, si dhe numrin e llogarise dhe kodin e bankes. Shtesat, konfirmimet ose perseritjet e urdhrave duhet te saktësohen dhe hartohen si te tilla.

c) Reference e vecante per urgjencat ne lidhje me ekzekutimin e nje urdhri

Nese Klienti mendon se nje urdher kerkon ekzekutim te menjehershëm, ai duhet te njoftoje posacerisht Banken per kete fakt.

d) Ekzaminimi dhe verejtjet per njoftimin e marre nga Banka

Klienti duhet të kontrollojë menjëherë pasqyrat e llogarise, pasqyrat e tjera, menyren e ekzekutimit të urdherave, si dhe informacionin për pagesat e pritshme dhe dergesat për sa i përket saktësisë dhe plotësisë dhe të paraqesë menjëherë vërejtjet në lidhje me to.

e) Detyrimi i ekzekutuar në llogari

Në rast detyrimi të Klientit ndaj Bankes, Klienti autorizon Bankën të debitojë të gjitha llogaritë e tij dhe në rast mungese gjendjeje, shuma e nevojshme kalon në gjendje në pritje (onhold) duke përfshirë në të gjithë fitimin dhe penalizimet e periudhës në pritje.

12. Kostoja e Shërbimeve Bankare

a) Normat e Fitimit dhe Komisionet: të gjitha Normat e fitimit dhe komisionet janë të shpallura në sportelet e Bankes në “**Lista e Produkteve, Shërbimeve & Çmimet**” si edhe në faqen e saj në internet. Nëse një Klient përdor një shërbim të listuar aty dhe nëse nuk është bërë një marrëveshje tjetër midis Klientit dhe Bankes e ndryshme nga ajo e listuar, do të aplikohet norma e fitimit dhe komisionet e publikuara. Për çdo shërbim tjetër jo të publikuar dhe që kryhet duke ndjekur udhëzimet e klientit, ose që besohet se është në favor të Klientit dhe që në rrethana të dhëna mund të kryhet vetëm kundërshtimisht, Banka mund të përcaktojë vetë komisione në masë të arsyeshme.

b) Ndryshimet në Norma fitimi dhe Komisione

Komisionet për shërbimet që klienti në kontekstin e marrëdhënieve të biznesit i përdor vazhdimisht (p.sh. një llogari rrjedhese), mund të ndryshojnë kur Banka e shikon të nevojshme. Klienti konsiderohet të jetë njoftuar me publikimin e këtyre ndryshimeve në mjediset e bankes dhe në faqen e saj në internet www.uba.com.al.

c) Shpenzime të tjera

Klienti paguan të gjitha shërbimet e tjera ekstra që kryhen nga Banka sipas udhëzimeve të Klientit (p.sh. pagesa për telefon, energji elektrike, etj).

13. Garancite për pretendimet e Bankes ndaj Klientit

1) Pengu në favor të Bankes

a) Marrëveshja për pengun

Banka përfiton një peng mbi të gjitha të drejtat që klienti ka ose mund të ketë në të ardhmen kundërshtimisht Bankes, të drejta që lindin nga marrëdhëniet Bankare (p.sh. teprica kreditore e llogarive).

b) Pretendimet e Siguruara

Pengu shërben për të siguruar të gjitha të drejtat ekzistuese, të ardhshme dhe të mundshme nga marrëdhëniet bankare që Banka, me gjithë zyrat e saj ka kundërshtimisht klientit. Në rast detyrimi nga ana e Klientit ndaj Bankes, Klienti autorizon Bankën të debitojë të gjitha llogaritë e tij dhe në rast mungese gjendjeje të kalojë këtë detyrim në balance negative duke aplikuar normat në fuqi të Bankes pasi ta ketë njoftuar me parë për shlyerjen e detyrimit.

2) Garancite dhe Letrat me Vlerë

a) Transferimi i pronesisë së Letrave me Vlerë

Banka fiton pronesinë mbi çdo çek të depozituar për arketim në kohën kur ata depozitohen.

b) Pretendimet mbi garancite

Pretendimet ndaj çeqeve do t'i kalojnë Bankes njëkohësisht me marrjen e pronesisë së çeqeve.

c) Pretendimet e siguruara të Bankes

Pronesia e transferuar apo e dhënë nepërmjet garancive shërben për të siguruar çdo pretendim që Banka mund të ketë kundërshtimisht Klientit, që lind nga llogaria rrjedhese e klientit kur letrat me vlerë depozitohen për arketim ose si rrjedhojë e ridebitimit të artikujve për arketim të papaguar. Përkundërshtimisht të Klientit, Banka i rikalon atij pronesinë dhe të drejtat që i kishin kaluar asaj, nëse ajo nuk ka, për kohën kur është bërë kjo kërkesë, ndonjë pretendim kundër klientit që duhet të garantohet ose nëse ajo nuk i lejon klientit të disponojë nga kundërvlera e këtyre artikujve përpara pagesës së tyre përfundimtare.

d) Kufizimi i pretendimit ndaj letres me vlerë

Banka mund të kërkojë që të jepet ose rritet garancia derisa vlera e realizueshme e gjithë garancive t'i korrespondojë shumës totale të gjithë pretendimeve që lindin nga marrëveshja e biznesit (limiti i mbulimit).

e) Ekzekutimi i garancise

Në rast ekzekutimi Banka mund të zgjedhë mes artikujve të ndryshëm të garancive. Kur ekzekutohet garancia dhe zgjidhen artikuj të ndryshëm për t'u ekzekutuar, Banka duhet të marrë në konsideratë shqetësimet legjitime të klientit dhe të çdo pale të tretë që mund të ketë vënë garanci për detyrimet e Klientit.

14. Perfundimi

a) E drejta e Bankes per Perfundim

Banka mund te perfundoje teresisht marredhenien e biznesit ne cdo kohe, nese nuk eshte rene me pare dakord per ndonje klauzole mbarimi.

b) Perfundimi me shkak te arsyeshem pa njoftim

Perfundimi i marredhenies se Biznesit teresisht apo pjesisht pa njoftim lejohet nese ka nje shkak te arsyeshem qe e ben te papranueshem per Banken vazhdimin e kesaj marredhenie, pasi te kete konsideruar sic duhet shqetesimet e Klientit.

Nje shkak i tille eshte ne vecanti kur klienti ka dhene deklarata te pasakta mbi statusin financiar te tij, duke pasur parasysh qe deklarata te tilla jane/kane qene me rendesi per marrjen e vendimeve nga ana e Bankes per dhenie financimesh apo aktivitete te tjera qe mbartin risk per Banken ose nese ndodh nje keqesim i gjendjes financiare te klientit, qe kerconon shlyerjen e detyrimeve ndaj Bankes apo shkaqe te tjera.

II. KUSHTE TE VEÇANTA

1. Llogarite e perbashketa

a) Detyrimi i perbashket dhe i veçante

Per detyrimet qe lindin nga llogarite e perbashketa, mbajtesit e llogarive detyrohen se bashku dhe vec e vec qe do te thote se Banka mund te kerkoje shlyerjen e gjithe pretendimeve nga secili mbajtes individual i llogarise.

b) Informacioni per llogarine dhe njoftime te tjera

Informacioi per llogarine dhe njoftimet e tjera do te dergohen gjithmone nga Banka ne adresen e deklaruar nga llogari-mbajtesit. Njoftimi i perfundimit te marredhenieve te biznesit, ose njoftimi i qellimit per te perfunduar do t'i dergohen secilit llogari-mbajtes.

c) E drejta per terheqje

Secili llogari-mbajtes mund te terheqe nga llogaria pa bashkepunimin e llogari-mbajtesve te tjere dhe mund te perfundoje gjithe marreveshjet qe kane te bejne me mbajtjen e llogarive dhe debitimin e llogarise.

Secili llogari-mbajtes mund te mbylle llogarite individualisht.

Ne rast vdekjeje te njerit prej llogari-mbajtesve e drejta per te terhequr e mbyllur llogarine i takon llogari-mbajtesit tjetër.

2. Transfertat

a) Parimet e pergjithshme

Banka kryen urdhrat e transfertave per llogari te Klientit me kujdesin maksimal. Klienti gjithashtu ka per detyre te bashkepusoje dhe ushtroje kujdesin e duhur.

b) Qartesia e Urdher Transfertave

Urdherat dhe udhezimet e cdo lloji duhet te tregojne ne menyre te qarte permbajtjen e transakcionit. Ne vecanti kur jep urdhera transferte klienti duhet te sigurohet qe detajet e urdherit te transfertes (emri i perfutuesit, numri i llogarise dhe kodi i Bankes) te jene te sakta, te plota dhe pa gabime. Klienti qe jep urdherin eshte gjithashtu i detyruar te dorezoje informacionin e nevojshem sic e kerkon Ligji Shqiptar. Transfertat me jashte kryhen ne baze te ligjeve dhe rregulloreve te aplikueshme per transakcionet valutore.

c) Urgjenca e pageses, hartimi i perseritjes.

Nese klienti mendon qe urdheri kerkon ekzekutim te menjehershem ai do te njoftoje Banken posacerisht per kete fakt. Nese ekzekutimi eshte i mundur Banka aplikon komisionin e vecante per kete sherbim. Konfirmimet ose perseritjet e urdherave duhet te hartohen si te tille.

d) Terheqja/Anullimi

Nje klient mund te terheqe ose te anulloje nje urdher transferte qe ka dhene vetem nese shuma nuk eshte kaluar ne procesin perfundimtar te tij. Banka do te perpiqet qe pagesa te mos perfundoje, por ne cdo rast Banka nuk mban pergjegjesi nese ky proces perfundon perpara perpjekjeve te punonjesve te saj. Gjithmone ne te tilla raste aplikohen komisionet e publikuara per anulhim dhe terheqje.

3. Depozitat me Afat

a) **Afati/kohezgjatja e depozites:** Kohezgjatja e depozites fillon ne ditën kur shuma e depozites eshte kredituar ne llogarine e depozites me afat fiks dhe mbaron ne ditën e sakte ne te cilen afati i rene dakort ka mbaruar ose nese kjo dite nuk eshte nje dite-pune e Bankes, ne dite-punen tjetër Bankare.

b) **Shuma minimale:** Shuma minimale qe mund te depozitohet ne nje llogari me afat fiks vendoset ne **“Lista e Produkteve, Sherbimeve & Çmimet”**

c) **Perfitimi:** do të paguhet nga dita kur fondet kreditohen në llogarinë e depozitës me afat fikse deri në datën e maturimit. Norma e perfitimit për afatin e rene dakord është fikse. Perfitimi i mbledhur kreditohet në llogarinë e percaktuar në fund të periudhës së specifikuar në kontratë.

d) **Disponimi/mbyllja e llogarise:** Gjate kohës së një marrëveshjeje depozite me afat fikse, nuk lejohen as depozitimet as tërheqjet. Ndryshimet e shumës së depozituar dhe mbyllja e llogarise janë të lejueshme vetëm në datën e maturimit të caktuar në marrëveshjen individuale të depozitës me afat. Nëse mbyllja e llogarise ndodh gjatë periudhës së investimit (përpara maturimit) Klienti nuk do të marrë fitimin.

4. Çeqet

Çeqet mund të shkruhen vetëm në formën e çeqeve të autorizuar nga Banka; Banka nuk është e detyruar të paguajë çeqe të shkruara në ndonjë formë tjetër. Blloqet e çeqeve leshohen kundrejt një kërkesë nga klienti.

a) **Detyra për të ushtruar kujdes në mbajtjen dhe përdorimin e blloqeve të çeqeve.**

Blloqet e çeqeve duhet të mbahen me kujdes të vecantë. Banka duhet të njoftohet menjëherë për humbjen e ndonjë blloku çeqesh.

Shuma në çek duhet të shprehet me shifra dhe me fjale në mënyrë të tillë që asgjë të mos shtohet. N.q.s. një klient gabon gjatë plotësimit të çekut, ose n.q.s. çeku demtohet në ndonjë mënyrë tjetër, ai duhet të eliminohet. Me përfundimin e marrëveshjes mbi çeket dhe/ose marrëveshjes mbi llogarinë rrjedhese, çdo çek i papërdorur duhet të kthehet menjëherë tek Banka ose të dërgohet tek Banka në një formë të zhvlefësuar.

b) **Shpërndarja e përgjegjësisë**

Banka është e ngarkuar të verifikojë autorizimin e paraqitesit të çekut. Ajo do të marrë përsipër vetëm detyrimin për neglizhencë të rende. N.q.s. Banka paguan çeqe që i kanë humbur klientit si rrjedhojë e leshimit tek një i tretë, Banka mund të debitojë llogarinë e klientit vetëm n.q.s. ajo, nuk ka vepruar me neglizhencë të rende në momentin e pagimit të çekut. Për më tepër, klienti do të përballojë detyrimin për çdo demtim të ndodhur si rezultat i humbjes së çeqeve që i janë leshuar atij, dhe si rezultat i pagimit nga Banka. Ky detyrim për klientin do të zbatohet vetëm n.q.s. pamja e jashtme e çekut të falsifikuar nuk e tregon qartë këtë, dhe n.q.s. nuk është leshuar asnjë urdher për të ndaluar këtë çek dhe nuk ka asnjë tregues tjetër parregullsie të cilin Banka logjikisht pritej që ta njihë.

c) **Pagesa e çeqeve**

Banka do të paguajë çekun e leshuar me nënshkrimin e klientit, nëse mbajtësi i çekut paraqitet për tërheqje Brenda 30 ditëve nga e data e leshimit.

Nëse ka kaluar një muaj nga data e leshimit, atëherë çeku nuk është më i pagueshem.

d) **Rregullat përfundimtare**

Mbajtësi i llogarise do të përballojë detyrimin për të gjitha pasojat që rrjedhin nga moszbatimi i kushteve dhe rregullave të mesipërme, dhe të gjitha demtet që rrjedhin nga humbja, keqpërdorimi, falsifikimi ose vjetërsimi i çeqeve dhe blloqeve të çeqeve. Masa në të cilën Banka mund të jetë përgjegjëse për demtet e ndodhura si rezultat i neglizhencës nga ana e saj do të matet me kontributin e saj, relative ndaj shkaqeve të tjera të ndodhjes së demtit.

5. Financimet

a) Banka mund të japë financime vetëm në përputhje me kushtet e politikës së Bankës dhe duke zbatuar një marrëveshje me shkrim. Banka mund të japë financime kundrejt garancive të pranueshme nga Banka. Mjetet e sigurimit të financimeve mund të përfshihen pa kufizim garanci dhe barre siguroese mbi aktivet, hipoteka mbi pasuri të paluajtshme, depozite Bankare në kesh, transferim i së drejtës mbi arketimet etj.

b) Banka vlerëson çdo aplikim për financim në baze individuale dhe sipas gjendjes financiare, ligjore dhe ekonomike të Klientit në kohën e aplikimit, dhe cilesisë së mjeteve të ofruara për sigurimin e financimit.

c) Nëse si rezultat i ndryshimit të një ligji ose rregulloreje, ose ndryshim në kërkesën e autoritetit drejtues ose rregullator të Bankës së Shqipërisë, do të ketë një rritje në kostot e Bankës për të dhënë, financuar ose mbajtur një financim, klienti do të rimbursojë Bankën me shumën e mjaftueshme për të kompensuar Bankën për këtë rritje të kostos.

6. Letrat e Kreditit

Banka mund të marrë parasysh kërkesat e Klientit për të hapur Letra Krediti. Në masën që Banka pajtohet me një kërkesë të tillë Banka do të hapë Letra Krediti vetëm në kushtet e pranuar nga Banka, duke përfshirë pa kufizim fonde të Klientit ose të Bankës sipas linjës së financimit që mund të miratohet për këtë qëllim, për të bërë sigurimin e pranueshem nga Banka. Në mungesë të ketyre mjeteve të sigurimit Banka mund të refuzojë kërkesën. Klienti paraqet kërkesën për të hapur Letër kredi duke i dhënë Bankës mundësi për t'ia komunikuar përfituesit këtë Letër Kredi.

Vetëm Klienti mban përgjegjësi për të dhënë udhëzime të plota dhe të qarta që përshkruajnë dokumentet dhe kushtet në të cilat duhet të bëhet pagesa, pranimi apo negociata për një Letër Kredi. Banka nuk është e detyruar të paguajë nëse paraqiten dokumente të cilat nuk janë të njëjta me kushtet e percaktuara në Letren e Kreditit, përderisa Klienti nuk do të kërkojë me shkrim që Banka duhet të pranojë këto dokumente për pagesë dhe të bjere

dakort për të demshpërbyer Banken kundrejt dëmeve ose humbjeve që mund të rezultojnë si rezultat i kësaj kërkesë.

Klienti njihë përgjegjësinë për të siguruar që kërkesat e tij për të hapur një Letër Krediti nuk bien në kundërshtim me legjislacionin dhe rregulloret shqiptare në fuqi. N.q.s Klienti nuk i përmbush këto kushte, Banka do të refuzojë kërkesën. N.q.s Bankës i shkaktohet ndonjë dëm ose humbje lidhur me mospërmbushjen nga Klienti të ligjeve dhe rregulloreve, Klienti është i detyruar të rimbursojë Bankën për gjithë dëmet ose humbjet e shkaktuara.

7. Overdraft në llogarinë rrjedhëse

Banka mund të aprovojë financim overdraft në llogarinë rrjedhëse të klienteve që marrin pagesa të rregullta mujore në llogari. Shuma e financimit overdraft vendoset nga Banka, bazuar në shumën e pagesave të rregullta mujore në llogari. Mbajtësit e llogarive të cilëve u janë miratuar overdraftet, mund t'i disponojnë lirisht fondet në llogari, që janë fonde të veta të shtuara me shumën e overdraftit. Banka ka të drejtë të miratojë një shumë overdrafti me të vogël se është kërkuar nga mbajtësi i llogarive, të kërkojë mjete shtesë sigurimi nëse gjykohej të nevojshme, ose ta refuzojë kërkesën për overdraft. Banka ka të drejtë, që pa njoftuar me parë mbajtësin e llogarive, të ndërprejë përdorimin e metejshëm të financimit overdraft.

*Në rastin e një tejkalimi limiti (), që është financimi kufi (overdraft) e pranuar/njohtur në heshtje nga banka, nëpërmjet të cilës banka i vë në dispozicion konsumatorit fonde të cilat tejkalojnë gjendjen (balancën) aktuale të llogarisë rrjedhëse të konsumatorit ose të financimit kufi (overdraftit), për të cilën është rënë dakord, Banka, vendos në dispozicion të konsumatorit me shkrësë ose nëpërmjet një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi, informacion në lidhje me *normën e fitimit të financimit dhe çdo indeks orientues ose normë referencë të aplikueshme për këtë normë fitimi, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e saj.**

Në rast të një tejkalimi të rëndësishëm/të konsiderueshëm të limitit, për një periudhë prej më shumë se 1 (një) muaji, banka njofton konsumatorin pa vonësë, me shkrësë ose nëpërmjet një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi, për:

- a) tejkalimin e limitit;
- b) shumën e tejkalimit;
- c) normën e fitimit;
- d) çdo penalitet, komision apo normë fitimi të aplikueshëm.

8. Overdraft në llogarinë rrjedhëse bazuar në fondet e depozitës (llogari depozite)

Banka mund t'u aprovojë financim overdraft klienteve që kanë depozita me Bankën, ku llogaria depozite shërben si mjet sigurimi (garanci). Kushtet dhe afatet e këtij miratimi, përcaktohen në një marrëveshje të vecantë ndërmjet bankës dhe mbajtësit të llogarive.

9. Overdraft i palejueshëm ose mos-përmbushje e kushteve të kontratës mbi llogarinë rrjedhëse.

Mbajtësi i llogarive është i detyruar të mbajë të dhëna mbi ndryshimet dhe gjendjen e llogarive rrjedhëse, dhe nuk duhet të shpenzojë tej limitit të llogarive rrjedhëse. Overdraft i palejueshëm konsiderohet kur llogaria rrjedhëse debitohet në një shumë më të madhe se shumën e lejuar, si dhe në rastin kur mbajtësi i llogarive nuk ka pagesa të rregullta mujore në llogarinë e tij, të cilat ishin baza për aprovimin e overdraftit nga ana e Bankës. Në rastin e overdraftit të palejueshëm, mbajtësi i llogarive detyrohet të paguajë menjëherë në llogari shumën e nevojshme për shlyerjen e detyrimit. Në rastin e overdraftit të palejueshëm, Banka ka të drejtë të kryejë veprimet e nevojshme për të eliminuar këtë overdraft dhe dëmet që mund t'i shkaktohen Bankës. Në rast të overdraftit të palejueshëm, Banka ka të drejtë, në zgjedhjen e saj, të ndërmarre veprimet e nevojshme:

- Te anulohet overdraftin në llogarinë rrjedhëse; Te marrë detyrimet e papaguara nga llogaria rrjedhëse, dhe nëse nuk mjaftojnë, nga çdo llogari tjetër e mbajtësit të llogarive me Bankën, përfshirë depozitat;
- Te fillojë procedurën ligjore kundër mbajtësit të llogarive;
- Te zgjidhë kontratën dhe të mbyllë llogarinë rrjedhëse.

10. Kartat e Debitit

Banka e Bashkuar e Shqipërisë u ofron mundësinë të gjithë klienteve të saj individë dhe biznes për t'u pajisur me Debit MasterCard, një kartë e sigurt nën funksionalitetin e Chip dhe PIN.

Kjo kartë e debitit lidhet direkt me llogarinë rrjedhëse duke ofruar një mënyrë më të lehtë për aksesimin e fondeve në llogarinë e Klientit. Me kartë Klientet mund të paguajnë në çdo pikë shitjeje ku shihet logoja MasterCard, në çdo dyqan, agjensi, supermarket, bar restorant, karburant, hotel, etj. të pajisur me POS-e si brenda ashtu dhe jashtë

vendit, si dhe të tërhiqen para cash nga ATM 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Karta e debitit është gjithashtu e përdorshme edhe për blerje në Internet.

Klientet mund të kontrollojnë gjëndjen e llogarisë si dhe të verifikojnë çdo transaksion të kryer nëpërmjet pasqyrës së gjëndjes së llogarisë (statement), duke pasur një kontroll të plotë të shpenzimeve të kryera.

Kushtet që rregullojnë përdorimin e kartave, Klientet mund t'i marrin duke bërë aplikimin për te.

Çmimet dhe tarifatat e detajuara për përdorimin e kartave gjenden në kopjen e kontratës që Klientet do të marrin pasi bëjnë aplikimin. Gjithashtu ato janë të publikuara dhe në faqen zyrtare të Bankës në web: uba.com.al.

11. Sigurimi dhe Kompensimi i Depozitave

- a) Depozitat tuaja janë të siguruar sipas Ligjit nr.53/2014 I ndryshuar "Për Sigurimin e Depozitave" I ndryshuar. Sigurimi behet nga Agjensia e Sigurimit të Depozitave (A. S. D.) e krijuar për këtë qëllim www.asd.gov.al.
- b) Ligji "Për sigurimin e depozitave" ben të detyrueshem anetaresimin prane A.S.D-se te te gjitha Bankave te vendit dhe te degeve te Bankave te huaja qe ushtrojne veprimtarine e tyre ne territorin e Republikes se Shqiperise. Banka e Bashkuar e Shqiperise Sh. A. eshte "Banke e Siguruar" dhe eshte pajisur nga Agjensia e Sigurimit te Depozitave me Certifikaten "Për Sigurimin e Depozitave" Nr.3, date 11.05.2009.
- c) Agjencia kompenson depozitën e siguruar, sipas dispozitave të ligjit, në masën 100 për qind dhe, në çdo rast, **jo më shumë se 2 500 000 Leke** (dy milionë e pesëqind mijë), për çdo depozitues individ, që operon në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht numrit të depozitave apo shumës së depozituar. Për tregtarët (PF) dhe shoqëritë tregtare, ky sigurim fillon nga data 01.01.2017 sipas parashikimeve të ligjit.
- d) Procesi i kompensimit nis në momentin kur ASD njoftohet nga Banka e Shqipërisë për ndërhyrje në bankën me probleme. Ky proces përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të tij.
- e) Kompensimi kryhet përmes:
 - pagesës së shumës në lek personit në ambientet e një banke anëtare të skemës (Banka agjente);
 - pagesës së shumës në lek personit në ambientet e subjektit të vendosur në likuidim në bashkëpunim me likuidatorin;
 - transfertës së shumës që përfitohet nga depozituesi në një bankë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave
 - pageses me çek;
 - menyra të tjera pagese të miratuara me akt nenligjor të Bankes së Shqiperise.
- f) Çdo depozitues mund të paraqesë ankimin e tij në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me kompensimin e depozitave pranë Agjencisë. Ankimi mund të bëhet brenda 14 ditëve nga marrja e njoftimit për kompensim, të cilin depozituesi ankimon.

Klienti: _____ **Sherbimi per Klientin:** _____

Data: _____

Klienti: _____ **Sherbimiper Klientin:** _____

Data: _____